





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Klan Kosova
Adriatik Kelmendi
Drejtör
Prishtinë



VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2021/306- Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
Klan Kosova (Palë përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përmes të cilit përcaktohet sjellja e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
2. KPM me datën 9 shtator 2021 i ka dërguar Palës përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073. Qëllimi i dërgimit të Udhëzuesit ka qenë që të licencuarve t'ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore gjatë Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës.
3. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, ka bërë monitorimin e përmbajtjeve programore gjatë heshtjes zgjedhore dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 17 tetor 2021, ka gjetur se Pala përgjegjëse në ditën e zgjedhjeve me datën 17 tetor 2021, ka transmetuar deklaratën e kandidatit për kryetar të Prishtinës nga AKR z. Gëzim Mehmeti: "*Prishtina meriton Gëzim, gëzuar*", si dhe deklaratën e kandidatit për kryetar të Mitrovicës z. Agim Bahtiri: "*Kryetari i juaj dhe kryetari i ardhshëm i Mitrovicës*", mezazhe këto politike që bien në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.
4. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 17 tetor 2021 i ka dërguar Njoftim për shkelje Palës përgjegjëse me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra, si dhe ka kërkuar që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke ndërmarrë veprime të menjëhershme që shkeljet e tilla të mos përsëriten.

5. KPM me datën 17 tetor 2021 ka pranuar përgjigje nga Palës përgjegjëse, në të cilën kanë theksuar se: *“Me qëllim që të mos bëhemi bashkë-shkelës të heshtjes zgjedhore, ne menjëherë kemi reaguar dhe duke e sqaruar situatën nga moderatorët në studio. Kjo mund të dëshmohej edhe nga materiali i xhiruar i gjithë maratonës zgjedhore. Për më tepër gjatë ditës ne e kemi zhvilluar edhe një intervistë me përfaqësuesit e zyrës suaj, për t'ua sqaruar qytetarëve përgjegjësinë e medieve gjatë heshtjes zgjedhore.”*

Analiza ligjore

6. Komisioni i Pavarur i Mediave, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.
7. KPM konstaton se edhe pse Pala përgjegjëse është njoftuar me kohë për respektim të Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhje, Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, i është dërguar Udhëzuesi me qëllim që t'ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore, sërish është gjetur në shkelje. Bazuar në Raportin e monitorimit KPM ka konstatuar se Pala përgjegjëse gjatë heshtjes zgjedhore, konkretisht në ditën e zgjedhjeve me datën 17 tetor 2021, ka bërë shkeljet nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, në ditën e zgjedhjeve me datën 17 tetor 2021, ka transmetuar deklaratën e kandidatit për kryetar të Prishtinës nga AKR z. Gëzim Mehmeti: *“Prishtina meriton Gëzim, gëzuar”*, si dhe deklaratën e kandidatit për kryetar të Mitrovicës z. Agim Bahtiri: *“Kryetari i juaj dhe kryetari i ardhshëm i Mitrovicës”*, mesazhe këto politike që bien në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073 i cili përcakton se:

“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.”


8. Komisioni duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 52, paragrafi 1, Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, për faktin se ka transmetuar material që propagandon mesazh të promovimit politik zgjedhor në kohën e heshtjes zgjedhore.

Vendim

9. Pala Përgjegjëse sanksionohet me **Vërejtje** në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
10. Pala Përgjegjëse obligohet që në të ardhmen të ndërmarrë veprime konkrete që shkeljet e tilla të mos përsëriten.

E drejta për ankesë

11. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
12. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Xhevat Latifi
Kryetar



20.10.2021
Datë